Ky kompensim-pagesë do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas ndarjes së kësaj parcele dhe në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

**XIV. Pagesa** e taksës administrative për leje ndërtimi dhe tarifës për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës, do të kalkulohet/realizohet sipas “Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës” 01 Nr. 434/01–0094474/17 dt.24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor/projektin ideor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës dhe tarifës, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr. 06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrërimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

Pagesa e taksës administrative do të llogaritet edhe për rrënimin e ndërtimeve ekzistuese në kuadër të parcelës kadastrale, bazuar në gjendjen ekzistuese, incizimin gjeodezik dhe projektin ideor të atyre ndërtimeve, me pagesën e taksës së përcaktuar në pikën 5.9 të nenit 5 të rregullores së lartcekur dhe vendimit për lejimin e rrënit.

**XV. Vlefshmëria** e vendimit për caktimin e kushteve ndërtimore është një (1) vit, me mundësi të vazhdimit për një (1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese apo dokumenti i planifikimit hapësinor, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

## A r s y e t i m

Aplikuesit/pronarët Gjyla Gashi, Ilir Hoxha, Luan Hoxha, Hazir Rexhepi nga Prishtina dhe investitorit “Kosova Home” shpk, me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.810008195, dhe me përfaqësues Hasan Canolli nga Prishtina, me kërkesën 05-350-124957/24 dt.23.09.2024, kanë kërkuar nga kjo drejtori, caktimin e kushteve ndërtimore/për hartimin e dokumentacionit ndërtimor-projektin ideor/kryesor për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa individuale banimore/shtëpi familjare, gjithsejtë për ndërtimin e 46 ndërtesave të banimit individual, të ndarë në 2 grupacione, grupacioni i parë me 28 ndërtesa të banimit individual dhe grupacioni i dytë me 18 ndërtesa të banimit individual, të gjitha shtëpi familjare në varg me etazhitet B+P+1, si dhe ndërtesa afariste, në shërbim të kompleksit-komunitetit, si: Ndërtesa afariste-komerciale, me etazhitet 2B+S+P+1, me infrastrukturë teknike përcjellëse, në kuadër të Planit Zhvillimor Urban-PZHU në Prishtinë, konkretisht në lokacionin e përshkruar në paragrafin I. të dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Me kërkesën për kushte ndërtimore 05 Nr. 350-124957/24 dt.23.09.2024 dhe gjatë fazës së zhvillimit të procedurës, është prezantuar dhe trajtuar dokumentacioni dhe provat, si në vijim:

- Dëshminë mbi pronësinë/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën nr. 10611-1, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10611-1 ZK Prishtinë, në emër të Hazir (Isa) Rexhepi të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit të Komunës së Prishtinës;
- Dëshminë mbi pronësinë/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën nr. 00536-4, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-00536-4 ZK Prishtinë, në emër të Luan (Rexhep) Hoxha të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit të Komunës së Prishtinës;
- Dëshminë mbi pronësinë/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën nr. 00536-2, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-00536-2 ZK Prishtinë, në emër të Ilir (Rexhep) Hoxha të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit të Komunës së Prishtinës;



- "Kontratë për ndërtimin e përbashkët", e lidhur në mes të pronarit Hazir Rexhepi dhe investitorit kompania "KosovaHome" sh.p.k, me seli në Prishtinë, me LRP nr.15681/2023 REF.nr. 2299/2023 dt.13.12.2023 te noteri Arbena Shehu në Prishtinë;
- "Kontratë për ndërtimin e përbashkët", e lidhur në mes të pronarit Ilir Hoxha dhe Luan Hoxha dhe investitorit kompania "KosovaHome" sh.p.k, me seli në Prishtinë, me LRP nr.2068/2024 REF.nr.300/2024 dt.23.02.2024 te noteri Arbena Shehu në Prishtinë;
- Dëshminë mbi pronësinë/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën nr. 533-0, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-00533-0 ZK Prishtinë, në emër të Gjyla (Sadri) Gashi të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;
- Dëshminë mbi pronësinë/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit për parcelën nr. 534-1, të evidentuar në certifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-00534-1 ZK Prishtinë, në emër të Gjyla (Sadri) Gashi të lëshuar nga Drejtoria e Kadastrit e Komunës së Prishtinës;
- "Kontratë për ndërtimin e përbashkët", e lidhur në mes të pronarit Gjyla Gashi dhe investitorit kompania "KosovaHome" sh.p.k, me seli në Prishtinë, me LRP nr.1682/2024 REF.nr.250/2024 dt.13.02.2024 te noteri Arbena Shehu në Prishtinë;
- "Kontratë për ndërtimin e përbashkët", e lidhur në mes të pronarit Gjyla Gashi dhe investitorit kompania "KosovaHome" sh.p.k, me seli në Prishtinë, me LRP nr.6262/2024 REF.nr.959/2024 dt.03.06.2024 te noteri Arbena Shehu në Prishtinë;
- Incizimi gjeodezik për parcelat kadastrale nr.10611-1, 534-6, 536-2, 533-0 dhe 534-1 ZK Prishtinë, i punuar nga kompania gjeodete "Topografia" sh.p.k me nr.të licencës 66;
- Informata nga plani me nr.ref.04-350/01-81794/24, dt.26.06.2024 lëshuar me dt.17.07.2024 nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik- Prishtinë.
- Kopjen e certifikatës së regjistrimit të biznesit të "KosovaHome" sh.p.k, me numër unik identifikues 810008195;
- Raporti i Komisionit Profesional për ofrimin e kushteve teknike për ndërtime në afërsi të stabilimenteve elektroenergjetike të tensionit të lartë nr.62 dt.09.01.2025/Përgjigje në kërkesë për dhënien e kushteve teknike lidhur me ndërtimin në ngastrën nr.533-0 dhe nr.534-1 ZK Prishtinë, përmes të cilës lejohet ndërtimi i objekteve të banimit në distancë më të madhe se 5m (pesë metra) ndaj projekcionit horizontal të përçuesit të skajshëm të linjës 110kV me Nr.L132-NS Kosova A-NS Prishtina 3, nga Operator, Transmisioni dhe Tregut Kost Sh.a;
- Një kopje të dokumentacionit ndërtimor/projektit konceptual të zgjidhjes urbane të shtëpive banimore familjare (në dy grupacione), në kopje të fortë/fizike me kopje digjitale në CD, të hartuar nga kompania projektuese "KosovaHome" sh.p.k me seli në Prishtinë, me certifikatë të regjistrimit të biznesit nr.810008195;
- Manuali i propozimit për bashkim dhe ndarje të parcelës kadastrale nr.10611-1, 534-6, 536-2, 533-0 dhe 534-1 ZK Prishtinë, punuar nga kompania gjeodete e licencuar "Topografia" shpk, me seli në Prishtinë, me licencë nr.66;
- Fotot e lokacionit;
- Fotokopja e letërnjoftimit të aplikuesve/pronarëve dhe investitorit.

Drejtoria e Urbanizmit dhe Mjedisit, pas shqyrtimit të kërkesës për kushte ndërtimore 05-350-124957/24 dt.23.09.2024, dokumentacionit të prezantuar me kërkesë dhe atë gjatë fazës së zhvillimit të procedurës administrative, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi nga lëmi i planifikimit hapësinor, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe dokumentet e planifikimit hapësinor për hapësirën ku gjendet lokacioni-Plani Zhvillimor Urban në Prishtinë, si dhe konsultimit të projekt propozimit – Projektit konceptual me "zgjidhja urbane" të prezantuar, në mënyrë kronologjike, konstatoi se:

Parcelat kadastrale, nr.10611-1, nr.536-4, nr.536-2, nr.533-0 dhe nr.534-1 ZK Prishtinë ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme për të dy grupacionet  $S=16517m^2$ , sipas certifikatës së njësisë kadastrale, grupacioni I  $S=8550m^2$  dhe grupacioni II  $S=7967m^2$  përfshihen në kuadër të Planit Zhvillimor Urban në Prishtinë, dhe sipas këtij plani, kjo hapësirë është e destinuar si hapësirë për ndërtimin e ndërtesave individuale banimore – shtëpive familjare, i cili destinim është konfirmuar përmes Shkresën "Informim nga Plani Zhvillimor Urban-PZHU", me referencë nr.ref.04-350/01-81794/24, dt.26.06.2024 lëshuar me dt.17.07.2024, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm e Komunës së Prishtinës, dhe i cili njëherit është destinim i propozuar nga aplikuesit.



Pas shqyrtimit dhe analizimit të saj, bazuar në analizën urb-arkitektonike - të Planit Zhvillimor Urban dhe projektit konceptual - "Situacionit", është konstatuar se ka mangësi në dokumentacionin e prezantuar, andaj përmes shkresës zyrtare "Plotësim dokumentacioni", me referencë 05 Nr.350/02-129848/24 dt.18.12.2024, ka kërkuar nga aplikuesi që t'i prezantojnë kësaj drejtorie; Certifikatat dhe kopjet e planit të parcelave kadastrale nr.533-0 dhe nr.534-1 ZK Prishtinë të përfshira në zgjidhjen urbane (jo më të vjetër se gjashtë muaj) origjinal ose kopje të vërtetuara te noteri; "Kontratë për ndërtimin e përbashkët" me LRP nr.1682/2024 REF.nr.250/2024 dt.13.02.2024 dhe "Kontratë për ndërtimin e përbashkët" me LRP nr.6262/2024 REF.nr.959/2024 dt.03.06.2024, origjinal ose kopje të vërtetuara te noteri; Projekti konceptual-zgjidhja urbane për tërë parcelat kadastrale të lartcekura, konkretisht propozimin për ndarjen e parcelave-riparcelimin e parcelave dhe secila duhet të respektoj kriteret Planit Zhvillimor Urban, si shputa, sipërfaqja ndërtimore dhe distancat nga kufiri i parcelës fqinje, kriteret këto për të cilat jeni njoftuar përmes Informata nga Plani Zhvillimor Urban, nr.ref.04-350/01-81794/24, dt.26.06.2024 lëshuar me dt.17.07.2024, të lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit Strategjik- Prishtinë; Të prezentohet Projekti konceptual-zgjidhja urbane sipas kriterëve të KOSTT, që e përcakton distancën ndaj projekcioni horizontal të përçuesve të skajshëm të linjës 110 KW; Kopje të dokumentit të identifikimit të pronarëve të parcelave;

Pas pranimit të shkresës "Plotësim Lënde" 05 Nr.070/01-17842/25 dt.04.02.2025, duke prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, kjo drejtori, analizoi Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe duke u bazuar në nenin 18 të Ligji Nr.04/L-110 për Ndërtim, pikën 1.2 dhe 1.2.2, të nenit 13 të Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, kjo drejtori me datë 19.03.2025, ka vendosur njoftimin publik në hapësira të dukshme dhe frekuentuese të lokacionit dhe rrethit në diametër prej 50 m', për të njoftuar publikun me synimet e pronarëve dhe investitorit, dhe i njëjti është lënë në dispozicion të tyre, për t'ju mundësuar të interesuarve paraqitjen e vërejtjeve dhe komenteve. Ky njoftim publik ka vazhduar të qëndrojë deri me datën 02.04.2025, dhe gjatë kësaj periudhe kohore, në postën elektronike zyrtare nuk ka arritur asnjë ankesë, kërkesë, vërejtje apo sugjerim nga qytetarët e asaj zone.

Në fazën e periudhës së qëndrimit të njoftimit publik, është analizuar projekt propozimi i prezantuar, si koncept dokument, dhe është konstatuar se i njëjti është hartuar në harmoni me kriteret e përcaktuara me PZHU-në, dhe se parcelat kadastrale të përfshira në trajtim, janë të shtrira në zonë të destinuar për "Ndërtim individual". Plani i situacionit-"zgjidhja urbane" e kompleksit në trajtim, është konceptuar të realizohet në dy grupacione, me trajtim të pesë parcelave kadastrale nr.10611-1, nr.536-4, nr.536-2, nr.533-0 dhe nr.534-1 ZK Prishtinë, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=16517m^2$ , dhe ku, bazuar në zgjidhjen urbane dhe në manualin e ndarjes e njëjta sipërfaqe është planifikuar të ndahet në gjithsejtë 46 njësi-parcela ndërtimore të ndarë në dy grupacione, grupacioni i parë me 28 ndërtesa të banimit individual, 28 njësi-parcela ndërtimore, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=6848m^2$  dhe parcela kadastrale-rrugë të planifikuara, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=1702m^2$  dhe grupacioni i dytë me 18 ndërtesa të banimit individual, të gjitha shtëpi familjare në varg, dhe një ndërtesë për funksione publike-ndërtesa afariste-komerciale, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=6646m^2$  dhe parcela kadastrale-rrugë të planifikuara, me sipërfaqe të përgjithshme  $S=1321m^2$ . Sipas projektit konceptual shtëpitë familjare të planifikuara për ndërtim, të konceptuara në tipe të realizimit - Tipi "Varg", me një ndërtesë për funksione publike-ndërtesa afariste-komerciale, me sipërfaqe dhe etazhitet sipas përshkrimit në paragrafin IV të këtij vendimi për caktimin e kushteve ndërtimore, janë në harmoni me kriteret e PZHU-së dhe Udhëzimin Administrativ të MMPH-së Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, si parcelat ndërtimore ashtu edhe sipërfaqet ndërtimore të ndërtesave-shtëpive, duke u bazuar në parcelat minimale dhe maksimale të kompleksit.

Aplikuesit dhe investitori, pas përfundimit të procedurës për bashkimin dhe ndarjen e parcelave të trajtuara, bazuar në manualin për bashkim dhe ndarje të parcelave kadastrale, sipas përshkrimit në paragrafin VI dhe VII të këtij vendimi, duhet të bëjnë edhe ndërrimin e llojit të shfrytëzimit të parcelave kadastrale-rrugëve të planifikuara brenda kompleksit të trajtuar, sipas përshkrimit në pikën VIII të dispozitivit të këtij vendimi.

Pas konsultimit të PZHU-së, dokument ky i planifikimit hapësinor i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Prishtinës, me Vendimin 01 nr.035-181427 dt. 24.09.2013, konkretisht dispozitat për zbatim të tij, konkretisht *Kapitulli 5.0*, lidhur me rregullativën ligjore të dokumentit të planifikimit hapësinor për



atë hapësirë, në këtë dokument ndër të tjera theksohet se, citojmë: “Çdo leje ndërtimore e lëshuar nga komuna duhet të jetë në pajtim me PZHU-në”, si dhe “Në të gjitha zonat që nuk ka plane rregulluese, minimumi i parcelës për aplikim është 30ari (3000m<sup>2</sup>) dhe kjo vlen deri në momentin që për atë zonë bëhet plani rregullues urban”, i cili kriter është plotësuar pasi që në rastin në trajtim, kemi të bëjmë me një sipërfaqe të përgjithshme të parcelave kadastrale prej S=16517 m<sup>2</sup>, (Grupacioni 1) me S=8550m<sup>2</sup> dhe (Grupacioni 2) me S=7967m<sup>2</sup>.

Njëherë, bazuar në parametrat dhe kriteret e përcaktuara me PZHU-në, konstatohet se për destinimet “Ndërtim individual”, ku lejohet ndërtimi i ndërtesave me I-III etazhe, me koeficient të shfrytëzimit të parcelës ISHP=0.2÷0.3 dhe me koeficient të ndërtimit ISPN=0.6÷0.8. është konstatuar se edhe projekt propozimi i prezantuar dhe trajtuar me këto kushte ndërtimore, është hartuar në harmoni me këto kriteret-parametra urban.

Bazuar në pikën 5.2.5. Kushtet dhe mënyra e ndërtimit të objekteve të banimit, paragrafi që përcakton distancën e vijës ndërtimore në raport me kategorinë e rrugëve, janë planifikuar rrugët e brendshme të kompleksit, me gjerësi deri 7 m, dhe në bazë të asaj gjerësie edhe është përcaktuar distanca minimale, gjegjësisht vija ndërtimore e pozicionimit të ndërtesave, e që është 5.0 m. Njëherë në këtë dispozitë janë përcaktuar edhe distancat minimale në mes të ndërtesave, konkretisht në zonat e reja të ndërtimit, e që është 1÷1.5H, ose nga kufiri i parcelës gjysma e kësaj distance, gjegjësisht 0.5÷0.75H, të cilat distanca dhe kriteret janë respektuar edhe në Planin e situacionit – “zgjidhja urbane” të prezantuar.

Duke u bazuar në nenin 21 pika 6 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikimin Hapësinor, ku thuhet se duhet të sigurohet baza ligjore e së drejtës për qasje nga parcelat kadastrale në rrugë publike, sipas projekt propozimit, kjo qasje është siguruar për grupacionin e parë është përmes rrugës lokale, ekzistuese, dhe e asfaltuar “Bardhok Biba” gjegjësisht parcelës kadastrale nr.1929-1 ZK Prishtinë, me pronar/posedues “P.SH. Rrugët”, me gjendje faktike dhe kadastrale “infrastrukturë-rrugë e pakategorizuar”, ndërsa për grupacionin e dytë përmes rrugës lokale ekzistuese gjegjësisht parcelës kadastrale nr.10287-90 ZK Prishtinë.

Poashtu pasi që në parcelën nr.533-0 ZK Prishtinë shtrihet linja e tensionit 110kV, pas përgjigje në kërkesë nr.62 dt.09.01.2025 për dhënien e kushteve teknike lidhur me lidhur me ndërtimin në ngastrën nr.533-0 dhe nr.534-1 ZK Prishtinë, lejohet ndërtimi i objekteve të banimit në distancë më të madhe se 5m (pesë metra) ndaj projeksonit horizontal të përçuesit të skajshëm të linjës 110kV me Nr.L132-NS Kosova A-NS Prishtina 3, nga Operator, Transmisioni dhe Tregut Kost Sh.a, janë respektuar distancat e përcaktuara nga Komisioni Profesional për ofrimin e kushteve teknike për ndërtime në afërsi të stabilimenteve elektroenergjetike të tensionit të lartë.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, është konstatuar rregullsia e Planit të situacionit – “zgjidhja urbane” dhe janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për kyçje të kompleksit me rrugën e brendshme të bllokut, me rrugën në e planifikuar të planit rregullues si dhe e njëjtat me rrugët tjera të planit ndër të tjera konstatohet:

*“Pas shqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të Gjyla Gashi, Ilir Hoxha, Hazir Regjepi në Prishtinë, lidhur me kërkesën për kushte ndërtimore të lëndës 05-350/02-124957/24 dt.26.09.2025, kyçja e rrugës së lagjes sipas zgjidhjes urbane në rrugën ekzistuese “Qemal Stafa” në Prishtinë, e cila rrugë është e paraparë edhe me Planin Zhvillimor Urban, sipas kësaj zgjidhjes urbane, mund të pranohet si e tillë, marrë parasysh edhe gjendjen faktike të rrugës ekzistuese, dhe zgjerimit të rrugës së planifikuar. Kyçja e rrugës së lagjes duhet të përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese “Qemal Stafa”, respektivisht zgjerimit të kësaj rruge sipas Planit Zhvillimor Urban, si dhe të zbatohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjeve të çdo ndërtese – shtëpie në rrugën e brendshme të zgjidhjes urbane”.*

Gjithashtu gjatë trajtimit të projekt kryesor, Komisioni këshillëdhënës formuar me Vendimin e Kryetarit të Komunës 14 nr.020/04 – 50254/24 dt.11.04.2025, për shqyrtimin e kushteve dhe lejeve ndërtimore, pas analizimit të projektit kryesor të prezantuar nga përfaqësuesit e aplikuesit /investitorit dhe shqyrtimit të dokumentacionit të prezantuar, dhe prezantimit nga projektuesi i investitorit me datën 21.05.2025 përmes procesverbalit, ka rekomanduar disa vërejtje, dhe ka udhëzuar zyrtarin/bartësin e landës që pas plotësimit të atyre vërejtjeve, verifikimit të saktësisë dhe vërtetësisë së dokumentacionit ndërtimor dhe aspekti urban i projekt propozimit kryesor, të vazhdojë me procedurën për caktimin e kushteve ndërtimore.



Bazuar në konstatimet e më sipërme dhe dokumentacionin e shqyrtuar, rregullativën ligjore në fuqi, konkretisht nenin 18 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim, nenin 21 të Ligjit Nr. 04/L-174 për Planifikim Hapësinor dhe nenin 13 të “Udhëzim Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Drejtoria e Urbanizmit ka konstatuar se kërkuessit kanë prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se plani i situacionit- “zgjidhja urbane”, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të planit rregullues urban për atë hapësirë, si dhe në harmoni me rrethinën, andaj konstatohet se janë plotësuar të gjitha kriteret e parapara ligjore për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore.

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

**Shtojcë:** Dispozita urbanistike -”zgjidhja urbane” me ndërtesa të planifikuara dhe manuali i bashkimit dhe ndarjes së parcelës kadastrale nr.10611-1, nr.536-4, nr.536-2 (Grupacioni I) dhe nr. 533-0 dhe 534-1 ZK Prishtinë.

**Udhëzim juridik:** Pala e pakënaqur me këtë vendim, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij vendimi. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do ti përcillet organit epror – MMPH.

**Ky vendim u printua në 4 (katër) kopje identike dhe i dërgohet:** Aplikuesve/Investitorit, Qendrës për shërbim me qytetarë, kësaj drejtorie dhe në dosje të lëndës 05 Nr.350/02-124957/24 dt.23.09.2024.

**Kopja elektronike i dërgohet:** Drejtorisë së Kadastrit dhe Drejtorisë së Planifikimit Strategjik.

**DREJTORIA E URBANIZMIT DHE MJEDISIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,  
05 NR. 350/02-124957/24 DT. 28.10.2025**

Zyrtari,  
Leonora Mehmeti  


Udhëheqëse e Sektorit,  
Nazife Krasniqi  










# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opstinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësish kadastrale / Br. katastarske jedinice: 536-2, 536-4  
1061-1

Zona kadastrale/ Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta:


Lloji i njësish kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana: 1:2500

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

## Propozimi per bashkim te parceleve

| Gjendja e vejtër |                                 | Gjendja e re per bashkim te parceles |                                            |
|------------------|---------------------------------|--------------------------------------|--------------------------------------------|
| Nr.parcele       | Siperfaqe sipas Certifikates m² | Nr.parcele                           | Siperfaqja pak korigjimit tekstule grafike |
| 536-2            | 1600                            | I ri-D                               | 8594                                       |
| 536-4            | 1600                            |                                      |                                            |
| 10611-1          | 5350                            |                                      |                                            |
|                  | 8550                            |                                      |                                            |



Rilevoi / Snimio: Topografia Sh.p.k

(emri dhe mbiemri i gjeodetit / kompanisë / imi i prezime geodeta/kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 66

Nënshkrimi / Potpis: B. Kelmus

Data e rilevimit / Datum snimanja: 21.06.2025



Aprovat / Usvojio: \_\_\_\_\_

(emri dhe mbiemri i gjeodetit / kompanisë / imi i prezime geodeta/kompanije)

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_









Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit / Ministrastvo Infrastrukture i Sredine / Ministry of Infrastructure and Environment  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opstinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësish kadastrale / Br. katastarske jedinice: i ri -0

Zona kadastrale/ Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta:

Lloji i njësish kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana: 1:1000

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis


### Propozim per ndarje te parcelave

| Prpozim per ndarje te parcelvae |                     |
|---------------------------------|---------------------|
| i ri -9                         | 220m <sup>2</sup>   |
| i ri -8                         | 220m <sup>2</sup>   |
| i ri -7                         | 222 m <sup>2</sup>  |
| i ri -6                         | 240 m <sup>2</sup>  |
| i ri -5                         | 240 m <sup>2</sup>  |
| i ri -4                         | 241 m <sup>2</sup>  |
| i ri -30                        | 12 m <sup>2</sup>   |
| i ri -3                         | 240 m <sup>2</sup>  |
| i ri -29                        | 252 m <sup>2</sup>  |
| i ri -28                        | 200 m <sup>2</sup>  |
| i ri -25                        | 209 m <sup>2</sup>  |
| i ri -24                        | 247 m <sup>2</sup>  |
| i ri -23                        | 240 m <sup>2</sup>  |
| i ri -22                        | 241 m <sup>2</sup>  |
| i ri -20                        | 311 m <sup>2</sup>  |
| i ri -2                         | 230 m <sup>2</sup>  |
| i ri -19                        | 223 m <sup>2</sup>  |
| i ri -18                        | 225 m <sup>2</sup>  |
| i ri -17                        | 223 m <sup>2</sup>  |
| i ri -16                        | 224 m <sup>2</sup>  |
| i ri -15                        | 225 m <sup>2</sup>  |
| i ri -14                        | 224 m <sup>2</sup>  |
| i ri -13                        | 258 m <sup>2</sup>  |
| i ri -12                        | 461 m <sup>2</sup>  |
| i ri -11                        | 1702 m <sup>2</sup> |
| i ri -10                        | 306 m <sup>2</sup>  |
| i ri -1                         | 239 m <sup>2</sup>  |
| 4i ri -27                       | 200 m <sup>2</sup>  |
| 4i ri -26                       | 200 m <sup>2</sup>  |
| 4i ri -21                       | 315 m <sup>2</sup>  |

Gjendja e vjeter

Propozim per ndarje te reja te parcelave

Trotuar



Rilevoi / Snimio: Topografia Sh.p.k

(emri dhe mbiemri i gjeodetit / kompanisë / imi i prezime geodeta/kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 66

Nënshkrimi / Potpis: [Signature]

Data e rilevit / Datum snimanja: 21.06.2025



Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_

(emri dhe mbiemri i gjeodetit / kompanisë / imi i prezime geodeta/kompanije)

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_









Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosova  
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment  
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opstinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: i ri -0

Zona kadastrale/ Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta:

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë


Shkalla e zvoglimit / Razmera plana: 1:1000

Lista e koordinatave, kod dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

Propozim per bashkim parcelave

| Gjendja e vjeter |                                             | Gjendja e re per bashkim te parcelave |                                                            |
|------------------|---------------------------------------------|---------------------------------------|------------------------------------------------------------|
| Nr .Parcele      | Siperfaqe sipas Certifikates m <sup>2</sup> | Nr .Parcele                           | Siperfaqja pas koorigjimit grafik tekstuale m <sup>2</sup> |
| 533-0            | 7065                                        | I ri -0                               | 7967                                                       |
| 534-1            | 902                                         |                                       |                                                            |
|                  | 7967                                        |                                       |                                                            |

— Gjendja e vjetër  
— Propozim per Bashkim



Rilevoi / Snimio: Topografia Sh.p.k

(emri dhe mblenri i gjeodeti / kompanisë / ime i prezime geodeta/kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 66

Nënshkrimi / Potpis: BK

Data e rilevimit / Datum snimanja: 21.06.2025



Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_

(emri dhe mblenri i gjeodeti / kompanisë / ime i prezime geodeta/kompanije)

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_









# Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosova

Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Ambientit/ Ministrastvo Infrastrukture i Sredine/ Ministry of Infrastructure and Environment

AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS/ KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA/ KOSOVA CADASTRAL AGENCY

Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë

Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: ri\_-0

Zona kadastrale/ Katastarska zona: Prishtinë

Numri i lëndës / Broj predmeta:


Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcelë

Shkalla e zvoglimit / Razmera plana: 1:1000

Lista e koordinatave, kodi dhe përshkrimi i tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

## Propozim per ndarjen e parcelave

| Prpozim per ndarje te parcelvae |      |
|---------------------------------|------|
| i ri-32                         | 208  |
| i ri-31                         | 310  |
| i ri-33                         | 201  |
| i ri-34                         | 201  |
| i ri-35                         | 200  |
| i ri-36                         | 207  |
| i ri-37                         | 209  |
| i ri-38                         | 214  |
| i ri-40                         | 293  |
| i ri-41                         | 215  |
| i ri-42                         | 283  |
| i ri-43                         | 279  |
| i ri-44                         | 251  |
| i ri-45                         | 241  |
| i ri-46                         | 203  |
| i ri-47                         | 214  |
| i ri-48                         | 257  |
| i ri-50                         | 2430 |
| i ri-49                         | 1321 |



Rilevoi / Snimio: Topografia Sh.p.k

(emri dhe mblenri i gjeodetit / kompanisë / ima i prezime geodeta/kompanije)

Nr. i licencës / Br. licence: 66

Nënshkrimi / Potpis: B. Kelmendi

Data e rlevimit / Datum snimanja: 21.06.2025

Aprovoi / Usvojio: \_\_\_\_\_

(emri dhe mblenri i gjeodetit / kompanisë / ima i prezime geodeta/kompanije)

Nënshkrimi / Potpis: \_\_\_\_\_

Data e aprovimit / Datum usvajanja: \_\_\_\_\_









Qasje nga rruga egzistuese

01929-1

00526-2

00536-3

00526-1

00525-0

00526-1

00536-1

Lokacioni i parceles

27-0

00528-0

00529-0

00530-1

00530-2

00532-6

00532-3

00532-4

00532-5

00531-3

00532-1

00535-0

10287-1

102

10

Linja e telave

Vija e distar


10287-23

10287

00534-0



POZICIONIMINÉ MASTERPLAN



Lagje Banimi Individual

[illegible]

VÉREJNÉ EVENTUÁLÉ



|           |            |                       |
|-----------|------------|-----------------------|
| PERMUDAJA | VOHEROES   | Hasan Canoli ark      |
| PK        | PROJEKTUES | Florjan Muhaxheri ark |
|           | KRYESORE   | Leonat Shabani ark    |
| VERIU     | DATA       | Shtator 2024          |

SITUACIONI I GJERË

# ARHITEKTURA

02 NR 1 FLETES